

## NEBIAL 3%



Solucion kripor hipertonic 3% me pH fiziologjik me acid hialuronik

Ka një veprim dekongjestionues në mukozën e hundës dhe ka efekt fluidizues në mukus. Ndhmon drenimin e sekrecioneve, ndaj përdoret për mbajtjen pastër të kavitetit të hundës, në ftohje, në rinite alergjike, në rinosinuzite, në sinuzite. Liron hundët e bllokuara duke përmirësuar frymëmarrjen. Prania e acidit hialuronik e bën të përshtatshëm për t'u administruar tek fëmijët. Acidi hialuronik është një substancë natyrale e prodhuar nga organizmi ynë, që ka funksion hidratimin e indeve. Ngjitja e tij mbi sipërfaqen e mukozës mban ujin në mënyrë fiziologjike në formën e një shtrese mbrojtëse që lehtëson mukozën e irrituar. Solucioni në brendësi mund të përdoret në terapi me aerosol.

### **Frekuenca e përdorimit:**

Tek latantët: hidhni disa pika në vrimën e hundës së bllokuar, disa herë në ditë, zakonisht para se të ushqeni fëmijën ose para ta vini për të fjetur.

Tek fëmijët: 1-3 shpëlarje për cdo vrimë hunde, 2-3 herë në ditë.

Tek adultët: 2-4 shpëlarje për cdo vrimë hunde, 2-3 herë në ditë.

**Përmbajtja:** solucion hipertonic 3% dhe acid hialuronik

Nuk ka konservantë.

### **Nuk përdoret:**

Në rast të hipersensibilitetit ndaj njërit prej përbërësve .

Produkti duhet të përdoret vetëm mbi mukozën e padëmtuar me integritet anatomik.

Nën fëmijët nën 1 vjec, përdorimi duhet të jepet me rekomandimin e mjekut.

Në rast të reaksioneve të padëshiruara ndaloni përdorimin dhe kontaktoni mjekun.

### **Efekte të padëshiruara:**

Nuk janë vënë re dhe as nuk janë parashikuar efekte anësore të lidhura me produktin. Provat mbi produktin nuk kanë evidentuar fenomene të hipersensibilitetit ose efekte të tjera anësore. Nebial 3% janë të një sigurie të provuar dhe lejojnë përdorim të përsëritur.

### **Paketimi:**

Kuti me 20 flakonë; 1 flakon 5ml